REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr.2324/2 Prot.

Vlorë, më 16/10/2026

VENDIM

"Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k me NUIS L66412202O, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë".

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.166, me Nr.2324 Prot., datë 05/08/2026, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, me seli në Vlorë (Lagjja "Rilindja", Rruga "Riza Salati", Godinë 4 katëshe; me adresë elektronike E-Mail: magsshoes4@gmail.com), me status në QKB "Aktiv". Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.2324/1 Prot., datë 05/08/2026, me lëndë "Njoftim Vendimi", por rezulton se zarfi me kod bar RR865743083AA është rikthyer në doganë me shënimin postar "Larguar".

Më tej, Dega e Doganës Vlorë ka vijuar me kryerjen e lajmërimit (njoftimit) publik me shkresat :

Nr.2429 Prot., datë 10/08/2026, me *"Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)"*, drejtuar Bashkisë Vlorë, e cila ka kryer konfirmimin e shpalljes publike me shkresën e saj nr.16655/1 Prot., datë 27/08/2026, me lëndë "Mbi kërkesën për konfirmim të shpalljes publike", e cila është administruar në doganë me nr.2429/1 Prot., datë 31/08/2026;

Nr.2430 Prot., datë 10/08/2026, me *"Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)"*, drejtuar Prefektit të Qarkut Vlorë;

Nr.2431 Prot., datë 10/08/2026, me *"Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e kontabilizimit)"*, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, e cila ka kryer afishimin me shkresën nr.15246 Prot., datë 14/08/2026;

Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me njoftimin elektronik të vendimit, me email-in e datës 10/08/2026, ora 10:54, me lëndë "Njoftim i aktit administrativ (Vendimi Nr.166, me nr.1691/1 Prot., datë 12-06-2026). Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar me shkresën Nr.2325/2 Prot., datë 18/09/2026 me lëndë "Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore"; me email-in e datës

26/09/2026 me lëndë "Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore, me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka rikërkuar subjektit debitor ekzekutimin vullnetar edhe të aktit administrativ të lartcituar.

Personi juridik debitor "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.166, me Nr.2324 Prot., datë 05/08/2026, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.166, me Nr.2324 Prot., datë 05/08/2026, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*,

V E N D O S A :

• Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.

• Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.

• Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "MAGS SHOES" sh.p.k, me NIPT L66412202O, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor Nr.166, me Nr.2324 Prot., datë 05/08/2026, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE - DEGA DOGANORE VLORË - MINISTRIA E FINANCAVE